

Data __. __. 2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje xhersa te levizshem

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Barriera mbrojtese 34928100-9

Barriera sigurie 34928310-4

VLERA E FONDIT LIMIT:

1.992.833 (nje milion e nentëqind e nentëdhjet e dy mije e teteqinde e tridhjet e tre) Leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Autoriteti Porttural Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar nuk duhet të jetë më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, dhe 2022 të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohej që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim,

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

2.1 Aftësitë teknike dhe profesionale:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit 2020, 2021, 2022 nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, kontratën midis

paleve ku të shënohet preventivi dhe vlera dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e Operatorit Ekonomik ofertues në ofrimin e mallrave që janë objekt prokurimi. kontraten pa vonesa dhe pengesa që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

1. FUSHA E VEPRIMTARISE

- Fusha e veprimtarisë duhet të jetë objekti i kontratës që prokurohet e cila duhet të jetë pjesë e veprimtarisë së Operatorit ekonomik, në plotësim të kësaj ;

Pershkrimi i Objektivit të veprimtarisë, në ekstraktin e regjistrimit tregtar (QKR) të operatorit, duhet të vertetojë këtë kusht.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është e nevojshme për të vertetuar që operatorit ka në objektin e veprimtarisë së tij fushën e kontratës që po prokurohet.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat të pershtatshme ose ekuivalentet e tyre për objektin e prokurimit si më poshtë:

Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO të sipërcituar).

Argumentim: Përbushja e standartit ISO 9001 ose ekuivalent është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kerkohen. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

- Ne menyre që të krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standardet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për listën e mallrave objekt prokurimi, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

- Dokumentin e titulluar Ofertë Teknike të paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në formën e një tabele kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi artikujt e

Listës. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë;

a) Emri i kompanisë prodhuese ose distributori i autorizuar nga prodhuesi me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në dokumentat e ofertimit. Adresa dhe web-siti të sakta të kompanisë prodhuese ose distributorit të autorizuar.

b) Emërtimi i Katalogut të prodhuesit.

c) Nr. i faqes në katalog referuar Nr. Identifikues të artikullit të ofruar sipas listës i shënuar me një shenjë dalluse.

Shenim 1 Specifikimet teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, shoqëruar me deklaratë mbi

përbushjen e specifikimeve teknike (shtojca 5, DT) të firmosura dhe të vëlosura nga ofertuesi nuk do të pranohen në cilësinë e Ofertes Teknike të kërkuar me sipër. Mos plotësimi i kesaj pike do të sjellë pavleshmëri të ofertes.

Shenim 2 Të dhënat e deklaruara në ofertën teknike të ofertuesit pika 2. V duhet të korespondojnë me të dhënat për to në Katalogë/Prospekte. Moskorespondimi i këtyre të dhënave do të sjellë pavleshmëri të ofertës.

Argumentim: Keto kritere janë të nevojshme për AK që të ketë informacione të detajuara për mallin që i ofrohet nga Operatori ekonomik.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë, për blerjet e reja cilësore, kërkesat aktuale për funksionalitet zgjerim cilësi e performancë si dhe shërbimet profesionale të kërkuara për teknologjite ekzistuese, ofrimin të produkteve të reja, karakteristikat e duhura bashkëkohore teknologjike, standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në çdo rast ku ka qenë e mundur është përdorur termi “ose ekuivalent” për të qenë gjithmonë në konformitet me zbatimin e legjislacionit të prokurimeve publike dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre.

**KOMISIONI PËR PËRGATITJEN E INFORMACIONIT SPECIFIC DHE
PËRLLOGARITJEN E VLERËS SË FONDIT LIMIT:**